

INFORMACION

Workshop dy ditor mbi:

“Rritjen e kapaciteteve për planifikim *ndërhyrjesh të bazuar në evidencë me fokus parandalimin e obezitetit në moshën feminare*”, Tiranë 28-29 Nëntor 2013

Në përmbushje të veprimeve dhe masave të Planit të Veprimit për Ushqimin dhe Ushqyerjen 2013-2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me OBSH-në, Zyra Rajonale për Europën dhe Zyra Qëndrore në Gjenevë po organizojne workshopin trajnues mbi: “Rritjen e kapaciteteve për planifikim *ndërhyrjesh të bazuar në evidencë, me fokus parandalimin e obezitetit në moshën feminare*”, duke përdorur një “mjet” të OBSH-së: “Prej të dhënave në veprime”.

Sot është duke u zhvilluar dita e dytë e takimit në sallën e mbledhjeve Vjena, në Hotel Rogner, me pjesëmarrës nga Ministria e Shëndetësisë, Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë që kanë kontribuar në hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Ushqimin dhe Ushqyerjen 2013-2020. Në fjalën përshëndetëse të Z/Ministrës së Shëndetësisë Zj. Milva Ekonomi u theksua se **Ministria e Shëndetësisë me vetëdije të plotë konsideron parandalimin dhe kontrollin e Sëmundjeve jo Të Transmetueshme (SJT) si një ndër fushat prioritare dhe është e angazhuar në përmbushjen e objektivave në këtë drejtim. Sëmundjet Jo të transmetueshme përbëjnë një sfidë të rëndësishme për zhvillimin social-ekonomik, dhe lehtësimin e varfërisë në vend. Për të gjitha këto, kontrolli dhe parandalimi i SJT-ve është pjesë e procesit të planifikimeve shëndetësore dhe e axhendës së zhvillimit në Shqipëri**

Ky aktiviteti pritet të jetë një kontribut i drejtëpërdrejtë në dhënien jetë aktiviteteve të PUU lidhur me dietën dhe aktivitetin fizik për të gjithë sektorët, nëpërmjet planifikimit të ndërhyrjeve më prioritare dhe të mundshme për tu realizuar sipas metodologjisë të përcaktuar nga OBSH-ja. Nderhyrjet prioritare të identifikuara do të përkthehen në plane pune të sektorëve përkatës të përfshirë në procesin e zbatimit të PUU lidhur me dietën dhe aktivitetin fizik.